



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

100, 111 / 20
18.03.2020

PRISHTINË - PRIŠTINA

PSH.nr.100/20
111/20

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068 dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje të: z. Blerim Dina - Kryetar , z. Nuhi Paçarizi - Referues, z. Goran Mileković - anëtare, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik: “Joos & Krasniqi-Bazë” Sh.P.K - Junik dhe ankesës së grupit të operatorëve “ARFA GROUP” Sh.P.K. & “EUROASPHALT” Sh.P.K. - Deçan , kundër njoftimit për anulim të aktivitetit të prokurimit me titull: “Ndërtimi i rrugës Junik-Gjeravicë”, me numër të prok: 636-19-5225-5-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/, Kuvendi Komunal Junik, më datë: 11.03.2020, mori këtë:

V E N D I M

I. **APROVOHET**, si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik: “Joos & Krasniqi-Bazë” Sh.P.K - Junik lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Ndërtimi i rrugës Junik-Gjeravicë”, me numër të prok: 636-19-5225-5-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/, Kuvendi Komunal Junik.

II. **HEDHET SI E PA LEJUAR**, ankesa e operatorit ekonomik: “ARFA GROUP” Sh.P.K. & “EUROASPHALT” Sh.P.K. - Deçan lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Ndërtimi i rrugës Junik-Gjeravicë”, me numër të prok: 636-19-5225-5-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/, Kuvendi Komunal Junik.

III. **ANULOHET**, njoftimi për anulim të prokurimit me titull: “Ndërtimi i rrugës Junik-Gjeravicë”, me numër të prok: 636-19-5225-5-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/, Kuvendi Komunal Junik, dhe lënda kthehet në rivlerësim.

IV. Autoriteti Kontraktues në afat prej 15 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

V. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

VI. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues: “Joos & Krasniqi-Bazë” Sh.P.K - Junik, aprovohet si e bazuar, kurse ankesa e OE “ARFA GROUP” Sh.P.K. & “EUROASPHALT” Sh.P.K. – Deçan, hedhet si e pa lejuar, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VII. Obligohen operatorët ekonomik ankues që konform nenit 31 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A R S Y E T I M

Operatori ekonomik ankues: “Joos & Krasniqi-Bazë” Sh.P.K - Junik, si palë e pa kënaqur, ka deponuar ankesë në OSHP, me dt.11.02.2020, me nr.100/20, kundër njoftimit për anulim të aktivitetit të prokurimit me titull: “Ndërtimi i rrugës Junik-Gjeravicë”, me numër të prok:636-19-5225-5-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/, Kuvendi Komunal Junik, duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenet: 1, 7, 24, 51, 56, 59, 60, 68, 69, 72 dhe 80 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës.

Operatori ekonomik ankues: “ARFA GROUP” Sh.P.K. & “EUROASPHALT” Sh.P.K. - Deçan, si palë e pa kënaqur, ka deponuar ankesë në OSHP, me dt. 18.02.2020, me nr. 111/20, kundër njoftimit për anulim të aktivitetit të prokurimit me titull: “Ndërtimi i rrugës Junik-Gjeravicë”, me numër të prok: 636-19-5225-5-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/, Kuvendi Komunal Junik, duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenet: 1, 6, 7, 59, 60, 62, 72 dhe 44.5 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 19.02.2020, ka autorizuar ekspertin shqyrtues të prokurimit, për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti shqyrtues i prokurimit në raportin e dt: 02.03.2020 sqaron si në vijim:

Pretendimi nr.1

OE Joos Krasniqi eliminohet nga ky aktivitet i prokurimit me arsyetimin se: Nuk e ka plotësuar kërkesën me nr.3, te pikës III.2.3. Kapaciteti ekonomik dhe financiar te paraqitur ne Njoftim për Kontrate dhe ne Dosjen e Tenderit si dhe kërkesat me nr.9 dhe 10, te pikës III.2.4. Kapaciteti teknik dhe profesional siç është kërkuar nga Autoriteti Kontraktues ne Njoftimin për Kontrate dhe ne Dosjen e Tenderit.

Sa i përket arsyes se pare te eliminimit, qe ka te beje me mbështetjen bankare, eksperti shqyrtues sqaron se i njëjti e ka dorëzuar dëshminë lidhur me kërkesën nr. 3 te DT-se. Lidhur me këtë arsye te eliminimit, AK-ja, nuk ka dhënë ndonjë sqarime me te detajuar se çfarë nuk plotëson me këtë dokument, mirëpo për çdo paqartësi ka mund te kërkoje informata sqaruese edhe nga banka e cila e ka lëshuar dokumentin ne fjale.

Lidhur me arsyen e dyte te eliminimit qe ka te beje me listën e pagave nga banka minimum 50 punëtore ne 6 muajt e fundit, te vulosur dhe nënshkruar, eksperti shqyrtues, fillimisht sqaron se OE ankues ka ofruar listat ATK-se dhe listat e Administratës Tatimore te R.Shqiperise ne te cilën figurojnë mbi 50 punëtore te lajmëruar.

Eksperti shqyrtues, sqaron se dëshmia nuk është sipas kërkesës se DT-se, megjithatë vlerëson se dëshmi nga bankës apo lista e pagave e lëshuar nga banka e vulosur dhe nënshkruar siç e ka kërkuar AK-ja, ne dosje te tenderit nuk mund te jetë më bindëse se sa lista e ATK-se, për faktin e sipas rregulloreve te ATK-se, deri ne një vlere te caktuar punëdhënësi mund ti jap page punëmarrësit edhe cash.

Prandaj, eksperti shqyrtues e vlerëson si devijim te vogël karshi kërkesës se dosjes se tenderit dhe njëherit kërkon qe kjo çështje te diskutohet ne seancën e cila do te organizohet pran OSHP-se.

Lidhur me arsyen e trete te eliminimit, eksperti shqyrtues, sqaron se AK-ja, ne arsyetimin e eliminimit është deklaruar se nuk e ka plotësuar piken 10 te kriterave teknike dhe profesionale, e qe pas ekzaminim te DT-se, eksperti shqyrtues sqaron se ne këtë pike janë dhjetëra pajisje teknik te kërkuara nga AK-ja për realizimin e projektit.

Eksperti shqyrtues, vlerëson se AK-ja, është dashur te cek decidivisht se cilat pajisje i mungojnë prandaj eksperti shqyrtues nuk mund te jap një mendim rreth kësaj çështje dhe njeherit i rekomandon AK-se qe gjate vlerësimit apo përgatitjes se letrave standarde te ceken konkretisht arsyet e eliminimit.

Pretendimi nr.2

OE Arfa eliminohet nga ky aktivitet i prokurimit me arsyetimin se: Partneri juaj nuk i ka përmbushur kërkesat e përshtatshmërisë. Nuk e plotëson kërkesën me nr.1, 4, 8, 9 dhe 10, të pikës III.2.4. Kapaciteti

teknik dhe profesional siç është kërkuar nga Autoriteti Kontraktues në Njoftimin për Kontratë dhe në Dosjen e Tenderit. Nuk e plotëson kërkesën me nr.3, të pikës III.2.3. Kapaciteti ekonomik dhe financiar të paraqitura në Njoftim për Kontratë dhe në Dosjen e Tenderit.

Eksperti shqyrtues, sa i përket arsyeve të eliminimit, sqaron se për të edhe OE “Joos Krasniqi” i ka pasur si pretendime ankimore për të cilat eksperti shqyrtues ka dhënë përgjigje në raportin paraprak, andaj, eksperti shqyrtues, i trajton si çështje të gjykuara me pare edhe në vendimin e PSH-se.

Sa i përket disa arsyeve lidhur me përvojën e stafit eksperti shqyrtues, vlerëson se AK-ja, gjatë vlerësimit sipas nenit 72 të LPP-se, është dashur të kërkojë sqarime lidhur me përvojën e stafit për faktin se të gjitha arsyet e përmendura në letrën standarde bëjnë pjesë tek kapaciteti teknik dhe profesional. Ndërsa sa i përket arsyes se OE ankues Arfa nuk e plotëson kërkesën për mbështetjen bankare eksperti shqyrtues, vlerëson se i njëjti e ka plotësuar për faktin se e ka dorëzuar dokumentin në fjalë në ofertën e tij.

Pavarësisht nga rivlerësimi i ofertave, eksperti shqyrtues sqaron se PSH-ja, me vendimin paraprakë e ka kualifikuar OE Arfa si pale pa interes juridik e material në këtë aktivitet të prokurimit konform nenit 4.1.26 të LPP-se.

Mendimi i ekspertit shqyrtues: Bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE-ve ankues të aprovohen si pjesërisht të bazuara dhe aktiviteti i prokurimit në fjalë të kthehet në ri-vlerësim.

Autoriteti Kontraktues, me datë: 03.03.2020 me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Operatori Ekonomik “Joos & Krasniqi-Bazë”Sh.P.K - Junik, me datë: 03.03.2020, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se pjesërisht pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Operatori Ekonomik “ARFA GROUP”Sh.P.K. & “EUROASPHALT”Sh.P.K. - Deçan, me datë: 03.03.2020, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se pjesërisht pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Seanca dëgjimore është mbajtur me datën: 11.03.2020, pa praninë e palëve konform nenit 24.1 të Rregullores së OSHP-së, e ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e

komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi për anulimin e aktivitetit të prokurimit, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit shqyrtues të prokurimit, dhe të gjithë parashtrësat e palëve në procedurë.

Lidhur me pretendimin e OE ankues “Joos & Krasniqi-Bazë”Sh.P.K – Junik se AK e ka eliminuar nga ky aktivitet i prokurimit me arsyetimin se nuk e ka plotësuar kërkesën me nr.3, të pikës III.2.3. Kapaciteti ekonomik dhe financiar të paraqitur në Njoftim për Kontrate dhe në Dosjen e Tenderit, si dhe kërkesat me nr.9 dhe 10, të pikës III.2.4. Kapaciteti teknik dhe profesional siç është kërkuar nga Autoriteti Kontraktues në Njoftimin për Kontratë dhe në Dosjen e Tenderit. Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues të prokurimit sqaron se sa i përket arsyes së parë të eliminimit, që ka të bëjë me mbështetjen bankare, OE ankues e ka dorëzuar dëshminë lidhur me kërkesën nr. 3 të dosjes së tenderit. Lidhur me këtë arsye të eliminimit, autoriteti kontraktues nuk ka dhënë ndonjë sqarim të detajuar se çfarë nuk plotëson me këtë dokument. Megjithatë, autoriteti kontraktues për çdo paqartësi ka mundur të kërkojë informata sqaruese edhe nga banka e cila e ka lëshuar dokumentin në fjalë.

Lidhur me pretendimin e OE ankues “Joos & Krasniqi-Bazë”Sh.P.K – Junik se AK e ka eliminuar me arsyetimin që ka të bëjë me listën e pagave nga banka, minimum 50 punëtor në 6 muajt e fundit, të vulosur dhe nënshkruar. Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se OE ankues ka ofruar listat e ATK-së dhe listat e Administratës Tatimore të Republikës së Shqipërisë në të cilën figurojnë mbi 50 punëtor të lajmëruar. Po ashtu, Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se dëshmia nuk është sipas kërkesës së dosjes së tenderit. Megjithatë, dëshmia nga banka apo lista e pagave e vulosur, nënshkruar dhe lëshuar nga banka siç e ka kërkuar AK-ja në dosje të tenderit nuk mund të jetë më bindëse se sa lista e ATK-së, për faktin se sipas rregulloreve të ATK-së, deri në një vlerë të caktuar punëdhënësi mund ti japë page punëmarrësit edhe cash.

Lidhur me pretendimin e OE ankues “Joos & Krasniqi-Bazë”Sh.P.K – Junik se AK e ka eliminuar me arsyetimin se nuk e ka plotësuar pikën 10 të kriterëve teknike dhe profesionale, Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se pas ekzaminimit të dosjes së tenderit, në këtë pikë janë dhjetëra pajisje teknike të kërkuara nga AK-ja për realizimin e projektit. Mirëpo, autoriteti kontraktues është dashur të cekë decidivisht se cilat pajisje i mungojnë. Andaj, Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues nuk mund të japë një konstatim rreth kësaj pike ankimore. Njëkohësisht, i rekomandon AK-së që gjatë vlerësimit apo përgatitjes së letrave standarde të ceken konkretisht arsyet e eliminimit.

Lidhur me ankesën e OE ankues “ARFA GROUP”Sh.P.K. & “EUROASPHALT”Sh.P.K. – Deçan, Paneli

Shqyrtues sqaron se me vendimin PSH.nr.658/19 të datës 31.10.2019 dhe vendimin PSH.nr.831/19 të datës 17.12.2019, OE “Arfa” është kualifikuar si palë pa interes juridik material në këtë aktivitet të prokurimit konform nenit 4.1.26 të LPP-së. Për më tepër, Paneli Shqyrtues sqaron se vendimi PSH.nr.1149/19 i datës 19.11.2019 i pamundëson që OE “ARFA GROUP” Sh.P.K të marrë pjesë në aktivitete të prokurimit në Republikën e Kosovës deri me datën 18.05.2020, për shkak se i njëjti është në listën e zezë. Andaj, ankesa e këtij operatori ekonomik hudhet si e pa lejuar.

Paneli Shqyrtues duke u bazuar në ecurinë e këtij aktiviteti të prokurimit, shkresave të lëndës të cilat i ka pasur në dispozicion si dhe në sqarimet e ekspertit shqyrtues, vlerëson se autoriteti kontraktues gjatë vlerësimit të ofertave nuk ka bërë ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e ofertave në pajtim me nenin 59 të LPP-së. Andaj, obligohet AK që gjatë ri vlerësimi të ofertave të kërkoj sqarime shtesë konform nenit 59.2 dhe 72 të LPP-së, dhe varësisht nga sqarimet, AK të bëjë vlerësimin e ofertave duke iu përmbajtur kërkesave të përcaktuara në njoftimin për kontratë, dosjen e tenderit dhe nenin 59 të LPP-së.

Gjithashtu Paneli shqyrtues sqaron se autoriteti kontraktues duhet ta ketë në konsideratë nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në diapozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t’i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues

z. Blerim DINA

Vendimi t’i dorëzohet:

- 1x1 AK - Kuvendi Komunal Junik
- 1x1 OE - “Joos & Krasniqi-Bazë” Sh.P.K – Junik
- 1x1 OE “ARFA GROUP” Sh.P.K. & “EUROASPHALT” Sh.P.K. - Deçan
- 1x1 Arkivës së OSHP-së;
- 1x1 Për publikim në web- faqe të OSHP-së.